



MINISTRI HASANI VIZITON KOSOVËN, RMV DHE MALIN E ZI: THELBËSOR FORCIMI I BASHKËPUNIMIT RAJONAL

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, zhvilloi në datat 16 – 18 janar një tur 3 ditor rajonal, ku vizitoi Kosovën, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi. Turi rajonal kishte si synim të bëjë më përmbajtësor, thellojë dhe konkretizojë më tej bashkëpunimin mes vendeve, si edhe zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të mira fqinjësore. Vizitat u fokusuan në marrëdhëniet dypalëshe, çështjet e sigurisë dhe e ardhmja e rajonit në Bashkimin Evropian.



MBYLLJA E MANDATIT TË KS, MINISTRI HASANI: SHQIPËRIA KA RRRITUR PROFILIN E SAJ NË ARENËN NDËRKOMBËTARE

Në përfundim të mandatit të Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit të OKB, Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, u shpreh se Shqipëria ka luajtur një rol dinjitoz, i cili është vlerësuar nga të gjithë, përfshirë miqtë dhe aleatët, si dhe nga shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare.



MINISTRI HASANI NGA BRUKSELI: JEMI GATI PËR KONFERENCËN E DYTË NDËRQEVERITARE SHQIPËRI-BE

MEPJ Igli Hasani mori pjesë në takimin e 17-të të Komisionit Parlamentar të Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri. Ministri Hasani vlerësoi mbështetjen institucionale që Parlamenti Evropian ka dhënë ndaj Shqipërisë ndër vite, për përparimin në rrugën e integritimit evropian, duke vënë në dukje se raporti i fundit i PE për Shqipërinë, i miratuar nga shumica dërrmuese e seancës plenare, është një dëshmi e fortë e kësaj mbështetjeje.



MINISTRI HASANI: TË FORCOJMË EDHE MË TEJ PARTNERITETIN STRATEGJIK SHQIPËRI-TURQI

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, Igli Hasani, priti në një takim Ministrin për Punët e Jashtme të Turqisë, Hakan Fidan. Ministri Hasani vlerësoi avancimin e marrëdhënieve Turqi-Shqipëri, teksa theksoi se mes dy vendeve ekziston potencial për një intensifikim të mëtejshëm të marrëdhënieve ekonomike dhe jo vetëm.



DITA E PËRKUJTIMIT TË HOLOKAUSTIT, MINISTRI HASANI: DIPLOMACIA SHQIPTARE, ROL VENDIMTAR NË SHPËTIMIN E HEBRENJVE

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit, në ambientet e MEPJ u zhvillua aktiviteti me temë “Shqiptarët zgjedhin për me shpëtue”. Ministri Igli Hasan vlerësoi rolin e diplomatëve dhe përpjekjet e popullit shqiptar në shpëtimin e hebrenjve, teksa u shpreh se evente të tilla shërbejnë për të na kujtuar që duhet të punojmë shumë, për të edukuar shoqëritë tona kundër çdo lloj urrejtje e diskriminimi racor, fetar, etnik, etj.



MINISTRI HASANI: ‘DITA E ALFABETIT’, FESTË KOMBËTARE E SHQIPËRISË

Data 22 nëntor, e cila shënjon ‘Ditën e Alfabetit’ shpallet festë kombëtare. Ministri Hasani u shpreh se 22 nëntori përfaqëson momentin më të madh unifikues të shqiptarëve, teksa nënvizoi se gjuha shqipe është ajo që i bashkon vërtetë shqiptarët kudo ndodhen nëpër botë.